



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Emërtimi i Modullit: PERKTHIM LETRAR

(KSHK 7, Kualifikim për të nxënit gjatë gjithë jetës 3, Programet e studimeve të formimit të vazhduar)

Programi i Formimit të Vazhduar : “PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”

Lloji i Trajnimit: Trajnim i drejtpërdrejtë, online dhe i kombinuar

Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime: *“Gjuha e burimit” anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip.*

“Gjuha e synuar” anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip.

Kohëzgjatja e programit të modullit: 30 orë 10 orë trajnim i drejtpërdrejtë ose online (3 ditë trajnimi)

5 orë studim i literaturës, materialit përkatës

15 orë përgatitje individuale për kryerjen e detyrave

Nr. i krediteve: 3 ECTS

Mënyra e zhvillimit: e kombinuar

- Seanca teorike: Për të kuptuar teorite mbi perkthimin letrar.
- Ushtrime praktike: Për të aplikuar njohuritë e fituara në perkthimin e teksteve letrare.
- Analiza të rasteve studimore: Për të shqyrtuar sfidat dhe zgjidhjet në perkthimin e teksteve të ndryshme letrare.
- Materiale mësimore të disponueshme online (video, artikuj, burime shtesë).
- Forume diskutimi për të ndarë përvojat perkthimore.
- Detyra dhe vlerësime online.

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Mësimdhënia në këtë kurs synon të pajisë me njohuritë bazë dhe themelore të perkthimit letrar. Qëllimi kryesor i këtij kursi është paraqitja e perkthimit letrar në kuptimin e gjerë të tij, domethënë me perkthimin e veprave letrare. Kombinimi i pjesës teorike me atë praktike do të përbëjë një hyrje në elementin letrar dhe në stil, si edhe në perkthimin që duhet të kalojë në procesin e analizës së teksteve. Në të njëjtën kohë do të paraqiten dhe shembuj të perkthimit të teksteve nga vepra klasike dhe bashkëkohore. - Nëpërmjet këtij trajnimi ofrohet përgatitja profesionale teoriko-analitike për letërsinë dhe perkthimin e saj. Ambjenti në të cilin punon perkthyesi letrar, karakteristikat e veçanta të llojeve kryesore të shprehjes letrare, Përgatitje profesionale për vështirësitë e perkthimit letrar.

OBJEKTIVAT E MODULIT:

- Të hartojnë paratekset që shoqërojnë tekstet letrare për perkthim;
- Të perkthejnë tekste letrare të vështirësisë mesatare;
- Të krijojnë mendimin e pavarur të perkthimit letrar.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**